



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 20.06.2024

Nr: 58

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. YLLI RUSHIT XHAFI, ANËTAR NË KESHILLIN E BASHKISË BULQIZË, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023.

Sot në datën 20.06.2024, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Ylli Rushit Xhafa, anëtar në Këshillin e Bashkisë Bulqizë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike e Shqipërisë", në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Palë të interesuara: Z. Ylli Rushit Xhafa, anëtar në Këshillin e Bashkisë Bulqizë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenet 90 dhe 95 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", i ndryshuar; ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; pikat 12 dhe 13 të kreut V të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

Data: 20.06.2024 Nr:58
Ora: 12:00



Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z.Ylli Rushit Xhafa, anëtar në Këshillin e Bashkisë Bulqizë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike e Shqipërisë"

VËREJ:

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe Anëtari në Këshillin e Bashkisë.

z. Ylli Rushit Xhafa, është propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike e Shqipërisë", si kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Bulqizë, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Për këtë kandidat në datën 02.04.2023, pranë KQZ është depozituar formulari e vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik. DI-PDSH-17581 unik. KQZ-ja bëri verifikimin "prima facie" dhe, pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtëm:

1. Nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, i kërkoi informacion zyrës së gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se subjekti vetëdeklarues z. Ylli Rushit Xhafa, nuk rezultoi të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.
2. Nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike i kërkoi informacion zyrës së gjendjes gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se subjekti vetëdeklarues z. Ylli Rushit Xhafa, rezultoi i rehabilituar.

Në përfundim të procesit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 577, datë 24.05.2023, i ka dhënë mandatin z. Ylli Rushit Xhafa, si anëtar në Këshillin e Bashkisë Bulqizë.

Pasi është konstatuar që kandidati nuk është në kushtet e ndalimit për të kandiduar, janë verifikuar të dhëna të tjera në formularin e vetëdeklarimit të z. Ylli Rushit Xhafa, ku rezultoi se ka deklaruar:

- Në rubrikën I. "TË DHËNA PERSONALE", PIKA B, "Gjeneralitete të mëparshme" të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar një emër tjetër në Greqi, që se mban mend.
- Në rubrikën III. "TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT", të Formularit të Vetëdeklarimit, Pyetjes 1 "A jeni dënues ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO", duke deklaruar se është proceduar në shtetin Grek në Lamia, dënimin e subjektit me 22 muaj burgim, duke mos deklaruar veprën penale dhe nëse vendimi ka marrë formë të prerë; Gjithashtu subjekti ka deklaruar se është proceduar nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, duke u dënues me masën e dënimit gjobë, duke mos deklaruar veprën penale dhe nëse vendimi ka marrë formë të prerë;
- Pyetjes 3 "A keni qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen një vepre penale?", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO", duke deklaruar se është proceduar në shtetin Grek, Lamia në janar të vitit 1994, për arsyet të cilat nuk i kujtohen; Gjithashtu subjekti ka deklaruar se është proceduar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me masën e dënimit me gjobë në vitin 2012;
- Pyetjes 4 "A keni qënë ndonjëherë i ndalues apo arrestues nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?" subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO", duke deklaruar se është

Data: 20.06.2024 Nr:58
Ora: 12:00



Për shqyrtimin e rezulttit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Ylli Rushit Xhafa, anëtar në Këshillin e Bashkisë Bulqizë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike e Shqipërisë"

proceduar në shtetin Grek, Lamia në janar të vitit 1994, për arsyet të cilat nuk i kujtohen. Gjithashtu subjekti ka deklaruar se është proceduar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me masën e dënimit me gjobë në vitin 2012;

- Pyetjes 5 "A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?" subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO", duke deklaruar se është proceduar në shtetin Grek, Lamia në janar të vitit 1994, për arsyet të cilat nuk i kujtohen;
- Pyetjes 7 "A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO", duke deklaruar se është proceduar nga policia, në shtetin Grek Athinë, arsyet të cilat nuk i kujtohen;
- Pyetjes 8 "A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj?", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO", duke deklaruar se ka qëndruar në Lamia Greqi, si emigrant për periudhën 1994, në Itali në San Marcelino, Napoli si emigrant në vitin 1998 dhe në shtetin Anglez në Oxford si emigrant prej vitit 1999 deri në 2005.

Nga konstatimet e mësipërme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4086 prot., datë 24.04.2023, vendosi t'ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 615/40 ext 23 prot., datë 16.04.2024, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin "Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Ylli Rushit Xhafa, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë kryer ndryshime në gjeneralitete, por rezulton të ketë përdorur në Greqi gjeneralitetet me të dhënat personale:
 1. Giannis Marcos i biri i Thanasi dhe Marika, i lindur më 01-01-1973 në Elbasan, Shqipëri;
 2. Grezegor Smykoëski i biri i Miroslav dhe Margaret, i lindur më 03-07-1973 në Poloni.;
- Rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë:
 1. nr.17/ 09-01-1995, nga Gjykata Tre Anëtarëshe e Apelit Penal të Athinës, Greqi, me tre vjet e dy muaj burg, për kryerjen e veprave penale të "vjedhjes" dhe "kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror", parashikuar si shkelje në ligjin 1300/82 & ligjin 1975/91, të Greqisë. Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë veprat e këtij të pandehuri, parashikohen aktualisht në nenin 134, paragrafi 1, dhe nenin 297,
 2. nr.17558 datë 12-03-2007, nga Gjykata e Dytë Tre Anëtarëshe të Kundërvatjeve të Athinës, me pesëmbëdhjetë muaj (15) burg i cili është konvertuar në 5 euro në ditë dhe 3000 euro gjobë, për kryerjen e veprave penale të "posedimit dhe përdorimit të pasaportës së falsifikuar" si dhe të "mohimit për të deklaruar të dhënat të tij reale të identitetit para organit të autorizuar të autoritetit", parashikuar në neni 87 prg.7 të ligjit nr.3386/05 dhe neni 225/2 të Kodit Penal, të Greqisë. Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë veprat e këtij të pandehuri, parashikohen aktualisht në nenin 189, paragrafi 1;
 3. nr. 139 datë 28.05.2014, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me 40.000 lekë gjobë, për kryerjen e veprës penale "Organizimi i palejuar i lojrave të fatit" parashikuar nga neni 197 të Kodit Penal;
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezulton të ketë qenë nën hetim ose gjykim:

Data: 20.06.2024 Nr:58
Ora: 12:00



Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z.Ylli Rushit Xhafa, anëtar në Këshillin e Bashkisë Bulqizë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike e Shqipërisë"

1. në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lamia, Greqi, për veprat penale të "vjedhjes" dhe "kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror", parashikuar si shkelje në ligjin 1300/82 & ligjin 1975/91, të Greqisë, për të cilat është deklaruar fajtor dhe dënuar, nga Gjykata e Tre Anëtarëshe e Apelit Penal të Athinës, me vendimin nr.17/ 09-01-1995,
 2. në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Athinë, Greqi, për veprat penale të "posedimit dhe përdorimit të pasaportës së falsifikuar" si dhe të "mohimit për të deklaruar të dhënat të tij reale të identitetit para organit të autorizuar të autoritetit", parashikuar në nenin 87 prg.7 të ligjit nr.3386/05 dhe nenin 225/2 të Kodit Penal, të Greqisë, për të cilat është deklaruar fajtor dhe dënuar, nga Gjykata e Dytë Tre Anëtarëshe të Kundërvatjeve të Athinës, me vendimin nr.17558 datë 12-03-2007,
 3. në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, për veprën penale "Organizimi i palejuar i lojrave të fatit" parashikuar nga neni 197 të Kodit Penal, në kuadër të procedimit penal nr. 44, datë 16.01.2014, i dërguar për gjykim më datë 16.04.2014 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër që e ka deklaruar fajtor dhe dënuar me vendimin nr. 139, datë 13.06.2014;
- Rezulton të jetë arrestuar në flagrancë:
 1. më datë 02-02-1994, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale "vjedhje" dhe "hyrje të paligjshëm në vend", parashikuar si shkelje në ligjin 1300/82 & ligjin 1975/91, të Greqisë, nga autoritetet ligjzbatuese në Lamia,
 2. më datë 08-03-2007, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të posedimit dhe përdorimit të pasaportës së falsifikuar si dhe të mohimit për të deklaruar të dhënat të tij reale të identitetit para organit të autorizuar të autoritetit, parashikuar në nenin 87 prg.7 të ligjit nr.3386/05 dhe neni 225/2 të Kodit Penal, të Greqisë, nga autoritete ligjzbatuese në Athinë;
 - Nuk disponohen të dhëna për masë sigurimi personal të caktuar, nga autoritetet gjyqësore të Greqisë;
 - Nuk rezulton të jetë lëshuar ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale;
 - Rezulton të jetë marrë për të masa e dëbimit nga territori i Greqisë, me vendimin gjyqësor nr.17 E.K.A. me numër rendor të çështjes së riadhesimit: 848/59, i cili është ekzekutuar më 24-03-2007, dhe regjistruar në Listën Kombëtare të të Huajve të Padëshiruar nga Departamenti i Dëbimit me datë hyrje në fuqi 12-03-2007 dhe datë heqje me 12-03-2027;
 - Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
 - Për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - Për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
 - Për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
 - Dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - Përdorimin e të dhënave personale /gjeneraliteteve të tjera.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1271 prot., datë 14.05.2023 ka kërkuar informacion shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme, nëse z. Ylli Rushit Xhafa rezulton i rehabilituar sipas ligjit Grek, në lidhje me dënimin e tij në këtë shtet.

Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. 1271/1 prot., datë 28.05.2023, i ka kthyer përgjigje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me subjektin z. Ylli Rushit Xhafa dhe sqaron se: “*Është kërkuar fshirja e të arratisurit në lidhje me dënimin e tij, pasi ka pushuar vlefshmëria e dënimit për shkak të parashkrimit në përputhje me nenin 118/c dhe 119 të Kodit Penal.*”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit, rezultatit të verifikimit të thelluar të Prokurorit të Përgjithshëm, korrespondencës shkresore me Prokurorinë e Përgjithshme konstaton se:

z. Ylli Rushit Xhafa, anëtar në Këshillin e Bashkisë Bulqizë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Referuar të dhënave të disponuara anëtari nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhshmërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të kreut V të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

V E N D O S:

1. Konstatimin se z. Ylli Rushit Xhafa, anëtar në Këshillin e Bashkisë Bulqizë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të anëtarit.
2. Vazhdimin e mandatit të z. Ylli Rushit Xhafa, anëtar në Këshillin e Bashkisë Bulqizë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI